



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2024:238102
Datë: 28.01.2025
Numri i dokumentit: 06768384

ARJ.nr.256/2024

GJYKATA SUPREME NË PRISHTINË - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Ragip Namani, kryetar, Zenel Leku dhe Beshir Islami anëtar, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale, Zanë Buçinca, procesmbajtëse, në çështjen juridike sipas padisë në konfliktin administrativ të paditësit/propozuesit, S.O., nga P., L.B i D., Rr. “S.I”., nr.150, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokat Naim Spahiu nga Prishtina, kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës (ATK), me seli në P., me bazë juridike anulim i vendimit me nr.327/2024 i datës 25.07.2024, me kërkesë për shtyrjen e ekzekutimit të njëjtit, duke vendosur lidhur me kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor të paditësit/propozuesit, paraqitur përmes të autorizuarit të tij, kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit në Prishtinë AA.nr.860/2024 të datës 17.10.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë, 21 janar 2025, merr këtë:

A K T V E N D I M

Aprovohet si e bazuar kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, e parashtruar nga paditësit/propozuesi, S.O., kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit në Prishtinë AA.nr.860/2024, të datës 17.10.2024.

Anulohen aktvendimi i Gjykatës së Apelit - Departamenti për Çështje Administrative AA.nr.860/2024, të datës 17.10.2024, dhe aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative A.nr.3627/2024, të datës 16.09.2024, dhe lënda i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

A r s y e t i m

Me aktvendimin e kontestuar të Gjykatës së Apelit në Prishtinë AA.nr.860/2024 të datës 17.10.2024, është vendosur si në vijim: I. Aprovohet si e bazuar ankesa e të paditurës/kundër propozueses, Administrata Tatimore e Kosovës, e datës 01.10.2024. II. Ndryshohet Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative A.nr.3627/2024, të datës 16.09.2024. III. Refuzohet si i pa bazuar propozimi i paditësit/propozuesit, S.O., nga Prishtina, me të cilën ka kërkuar shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të paditurës Administratës

Tatimore e Kosovës, me numër prot.327/2024 të datës 25.07.2024, derisa gjykata të vendosë me vendim përfundimtar gjyqësor përkitazi me padinë e paditësit.

Kundër aktvendimit të lartë cekur të Gjykatës Apelit, paditësi përmes të autorizuarit të tij, në afat ligjor në Gjykatën Supreme parashtron kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, me të cilën e konteston ligjshmërinë e të njëjtit për shkak të: shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës, dhe për shkak të shkeljes të së drejtës materiale, me propozim që të: I. APROVOHET si e bazuar kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm e paditësit, të ndryshoj aktvendimin e Gjykatës së Apelit, Departamenti për Çështje Administrative AA.nr.860/24, të datës 17.10.2024, ashtu që të refuzohet si e pa bazuar ankesa e të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës, me seli në P dhe të mbetet në fuqi aktvendim A.nr.3627/2024, të datës 16.09.2024, i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative me të cilin është vendosur që të: Aprovohet e bazuar kërkesa e paditësit "S.O., me numër personal, me adresë Rr. ".....", nr.... B.D., P"., dhe që shtyhet ekzekutimi i vendimit me nr.prot: 327/24, të datës 25.07.2024, të nxjerr nga Administrata Tatimore e Kosovës, derisa gjykata të vendos me vendim përfundimtar gjyqësor përkitazi me padinë e paditësit, ose Gjykata Supreme e Kosovës aktvendimin e atakuar ta PRISH dhe çështjen ta kthej në rigjykim në Gjykatën e Apelit-Departamenti për Çështje Administrative.

Gjykata Supreme në përputhje me nenin 53 të LKA-së mbajti seancën, vlerësoi pretendimet e paraqitura në kërkesë, ekzaminoi aktvendimin e kontestuar të gjykatës së shkallës së dytë dhe atë të shkallës së parë dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave të tjera të lëndës gjen se:

Kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se e paditura me vendimin e saj përfundimtar në procedurë administrative me numër prot.327/2024 të datës 25.07.2024 e refuzon si të pa bazuar ankesën me nr. 327/24 të subjektit në procedurë të dt. 21.06.2024 në mbështetje të nenin 132/2, të Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurat administrative, ndërsa mbetet në fuqi Vendimi mbi Njoftim Rivlerësimet të tatimit shtesë të dorëzuar nga kontrolli. Në arsyetim ndër të tjera arsyeton se; në këtë çështje pas shqyrtimit të provave materiale, raportit të kontrollit të dt. 24.05.2024, Njoftim rivlesimeve pas kontrollit si dhe shkresave të tjera të lëndës tek paditësi, konstaton se vlerësimi i kontrollit është bërë mbështetur nen nenin 9 dhe 15 të Ligjit nr. 08/L-257 mbi administrimin e Procedurave tatimore të cilat i citon dhe konstaton se, qarkullimi shtesë bazuar në provat e administruara ka rezultuar sipas deponimeve në llogari bankare PCB në vitin 2019 në vlerë totale prej 11,000.00€uri, si dhe për diferencën e pagesës së parcelës, për të cilën tatimpaguesi ka potencuar se është kryer në kesh, në mungesë të argumentimit të burimit të mjeteve. Pretendimet e tatim paguesit se kontrolli pa të drejtë nuk i ka njohur kontratat e huazimit, mjete këto me qëllim të pagesës së pjesës së parcelës së blerë, njësia e ankesave pas analizimit të dokumenteve të dosjes së lëndës vërteton se, mbetet në fuqi vlerësimi i kontrollit sepse gjatë seancës pretendimet e tij, tatimpaguesi nuk arrin ti mbështesë në argumente të mjaftueshme dhe esenciale për të ndryshuar Njoftim rivlerësimet e Tatimit Shtesë të caktuara me kontroll, andaj konstaton se vendimi mbi njoftim Rivlerësimet e Tatimit shtesë të caktuara nga ATK Drejtoria e Tatimpagueseve të Mesëm, janë të drejta dhe të bazuara në dispozitat ligjore në fuqi të ATK-së.

Kundër këtij vendimi, paditësi parashtron padi në Gjykatën Themelore –Departamenti për Çështje Administrative në Prishtinë dhe kërkesë për masë të përkohshme për shtyrjen e

ekzekutimit të vendimit të organit të paditur deri sa gjykata të vendos çështjen kryesore me vendim përfundimtar në procedurë të konfliktit administrativ

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, me aktvendimin A.nr.3627/2024, të datës 16.09.2024, ka vendosur si në vijim: I. Aprovohet kërkesa e paditësit S.O., nga P., Lagjja B i D., Rr. "S.I" nr... për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit nr.327/2024 i datës 25.07.2024 të Administratës Tatimore të Kosovës. Në pikën II. Shtyhet ekzekutimi i vendimit nr.327/2024 i datës 25.07.2024 të Administratës Tatimore të Kosovës, derisa gjykata të vendos me vendim përfundimtar, përkitazi me padinë e paditësit në këtë konflikt administrativ.

Në arsyetim të aktvendimit të gjykatës së shkallës së parë ndër të tjera theksohet se; nga provat e bashkangjitura padisë dhe kërkesës për shtyrje të ekzekutimit të vendimit të atakuar me padi, ka vlerësuar se paditësi ka ofruar prova dhe argumente të besueshme se në rastin konkret janë përmbushur kushtet ligjore të parapara me dispozitën e nenit 22 të LKA dhe të Ligjit nr.03/L-222 për Konfliktet Administrative, për shtyrje të ekzekutimit të vendimit. Deri tek ky konstatim gjykata erdhi pasi që analizoj provat e paraqitura e bashkangjitura padisë nga paditësi, e ku përfshihet pasqyra e llogarisë bankare e paditësit me nr. ...-....., në TEB-Bankë, nga ku shihet se paditësi bilancin në llogarinë e tij bankare personale e ka në shumën prej 283.48€, për periudhën nga data 01.01.2024 deri me datë 27.08.2024. Nga kjo rezulton se paditësit aktualisht nuk ka mjete financiare të mjaftueshme në dispozicion për pagesën e detyrimeve tatimore me të cilat është ngarkuar nga e paditura. Bazuar në provat e bashkangjitura kërkesës për shtyrje të ekzekutimit të vendimit nga paditësi vlerëson se ekzekutimi i këtij vendimi do të mund ti shkaktonte paditësit dëm i cili vështirë se do të riparohej, duke marr parasysh faktin se paditësi si person fizik, ka përgjegjësi të pakufizuar personale për të gjitha borxhet dhe detyrimet tjera të shkaktuara, ose të imponuara nga një ligj ose kontratë dhe se në rastin konkret organi i paditur bazuar në dispozitat e Ligjit nr.08/L-257 për Administrimin e Procedurave Tatimore, nenet 29-36 të tij, ka të drejt të regjistroj barrën tatimore në pasurinë apo në të drejtën pasurore që i përket atij personi-paditësit, qoftë e luajtshme apo e paluajtshme, e trupëzuar apo e patrupëzuar, të bllokoj llogaritë bankare të paditësit, të merr/konfiskoje pasurin e luajtshme dhe të paluajtshme të paditësit, të shes në ankand atë pasuri, të aplikoj embargo në import dhe eksport, veprime këto të cilat do t'ia pa mundësonin paditësit pa shmangshëm zhvillimin e aktivitetit të tij afarist. Nga ana tjetër gjykata vlerëson se shtyrja e ekzekutimit të vendimit të kontestuar të ATK-së nuk është në kundërshtim as me interesin publik dhe interesin e palës kundërshtare, në këtë rast të paditurës, ngase e paditura për çdo ditë vonese në pagesën e detyrimeve tatimore nga ana e paditësit, të njëjtin e ngarkon me pagesën e interesit të paraparë me nenin 51 të Ligjit nr.03/L-222 dhe nenin 24 të Ligjit nr.08/L-257 për Administrimin e Procedurave Tatimore.

Kundër këtij aktvendimi ka ushtruar ankesë përfaqësuesi i autorizuar i të paditurës-kundër propozueses, ATK, me të cilën e konteston ligjshmërinë e të njëjtit, për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit, të aprovoj ankesën e të paditurës si të bazuar, të anulohet aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë A.nr.3627/2024 dhe të mbetet në fuqi vendimi i Departamentit të Ankesave Nr.327/2024 të datës 25.07.2024 si vendim i ekzekutueshëm.

Gjykata e Apelit në procedurë ankimore me aktvendimin e kontestuar me kërkesë, duke vendosur si në kuptim të nenit 194, të LPK-së, (ligj i aplikueshëm në kuptim të nenit 63 të LKA-së), e aprovon ankesën e të paditurës/kundërpropozuesit si të bazuar ndërsa aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë e ndryshon dhe e refuzon si jo të bazuar propozimin e paditësit për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të paditurës me nr. prot. 327/2024, të dt. 25.07.2024. Në arsyetim pasi

bënë përshkrimin e gjendjes së vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë, nuk e pranon si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin juridik të saj, nga se sipas vlerësimit të kolegjit në rastin konkret nga paditësi nuk janë plotësuar në mënyrë kumulative kushtet për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të organit të paditur, ashtu si parashihet në nenin 22 të LKA-së.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, pikëpamjet juridike të gjykatës së shkallës së parë, nuk mund ti përkrahë si të rregullta dhe të ligjshme, për arsye se aktvendimi i ankimuar është i përfshirë me të metat thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.2 të LPK pika nën n) e cila përcakton se: “në qoftë se aktgjykimi ka të meta për shkak të të cilave nuk mund të ekzaminohen, e sidomos në qoftë se dispozitivi i aktgjykimit është i pakuptueshëm apo kontradiktor me vetvete ose me arsyet e aktgjykimit, apo nëse aktgjykimi nuk ka fare arsye apo në të nuk janë treguar fare arsyet për faktet vendimtare, ose ato arsye janë të paqarta, ose kontradiktore, ose nëse për faktet vendimtare ekzistojnë kundërthënie midis asaj që në arsyet e aktgjykimit thuhet për përmbajtje të dokumentit ose të procesverbalit për thëniet e dhëna në procedurë dhe të vet atyre dokumenteve ose të procesverbalit”.

Kolegji i kësaj gjykate, pikëpamjet juridike të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, nuk i përkrah si të rregullta dhe të ligjshme për arsye se aktvendimi i atakuar është përfshirë edhe me të meta juridike për shkak të qëndrim të gabuar juridik të gjykatës së shkallës së parë, të parapara me nenin 183, respektivisht 183.1 ku përcaktohet se: “Ekziston vërtetimi i gabuar apo jo i plotë i gjendjes faktike kur gjykata gabimisht e ka vërtetuar ndonjë fakt vendimtar, përkatësisht kur faktin e tillë nuk e ka vërtetuar fare”. Në rastin konkret gjykata e shkallës së parë nuk e ka vlerësuar fare ose e ka vlerësuar në mënyrë të gabuar faktin se me shtyrjen e ekzekutimit të vendimit kontestues, paditësit-propozuesit mund ti shkaktohet dëm i riparueshëm e gjithashtu gabimisht e ka vlerësuar edhe faktin se shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik.

Gjykata e Apelit vlerëson se, gjykata e shkallës së parë në rastin konkret nuk e ka vlerësuar drejtë propozimin për shtyrje të ekzekutimit të vendimit, për shkakun se i njëjti propozim nuk ka paraqitur asnjë provë ose kushte të cilat janë të parapara me ligj e të cilat e bëjnë të mundur shtyrjen e vendimit të kontestuar, ndërsa arsyetimi i aktvendimit të ankimuar, sipas kolegjit të kësaj gjykate, është i mangët me mos vlerësimin e fakteve vendimtare. Andaj, për shkak të qëndrimit të gabuar juridik dhe mos arsyetimit të aktvendimit të ankimuar, gjykata e shkallës së parë, ka lëshuar të vërtetoi faktet qenësore për zbatimin e dispozitës së nenit 22 par.2 të LKA-së, për çka ankesa është dashtë që të aprovohet e të ndryshohet aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë dhe propozimi i paditësit për shtyrje të ekzekutimit të vendimit kontestues të refuzohet.

Kolegji i kësaj gjykate, duke i marrë parasysh pretendimet e paraqitura me propozim dhe në ankesën e ushtruar, si dhe të tjerat të cilat gjenden në padi dhe në shkresat e lëndës, në përputhje me nenin 49 të LKA-së, lidhur me nenin 209 pika c) të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga gjendja e tillë e kësaj çështje si më lartë nuk mund ti pranojë si të drejta dhe ligjore pikëpamjet juridike të gjykatave të instancave më të ulëta, sepse në aktvendimet e tyre nuk i kanë paraqitur arsyet për faktet vendimtare, kurse arsyet e paraqitura janë të paqarta lidhur me faktet vendimtare të pa vërtetuara dhe arsyetuara si duhet, lidhur me objektin e çështjes në shqyrtim, për çka edhe është bërë vërtetimi jo i plotë i gjendjes faktike, si rezultat i së cilës është bërë edhe zbatimi i gabuar i të drejtës materiale.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, aktvendimi i gjykatës së shkallës së dytë dhe shkallës së parë janë të përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të parashikuar nga nenin 182 par.2 pika (n) dhe pika (f) të Ligjit të Procedurës Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së. Kështu, në nenin 182 par.2 pika (n) të LPK-së parashikohet që shkelja thelbësore e dispozitave të procedurës kontestimore ekziston gjithmonë *“në qoftë se aktgjykimi ka të meta për shkak të të cilave nuk mund të ekzaminohen, e sidomos në qoftë se dispozitivi i aktgjykimit është i pakuptueshëm apo kontradiktor me vetvete ose me arsyet e aktgjykimit, apo nëse aktgjykimi nuk ka fare arsye apo në të nuk janë treguar fare arsyet për faktet vendimtare, ose ato arsye janë të paqarta, ose kontradiktore, ose nëse për faktet vendimtare ekzistojnë kundërthënie midis asaj që në arsyet e aktgjykimit thuhet për përmbajtje të dokumentit ose të procesverbalit për thëniet e dhëna në procedurë dhe të vet atyre dokumenteve ose të procesverbalit”*. **Ndërsa në pikën f) të tij shkelja ekziston gjithmonë *“në qoftë se gjykata ka vendosur për kërkesëpadinë për të cilën është me kompetencë lëndore gjykata më e lartë e llojit të njëjtë, gjykata e llojit tjetër”*.**

Gjykatës Supreme vlerëson se gjykata e instancës më të ulëta nuk kanë zbatuar dispozitat e LPK-së, që i referohen kompetencës së gjykatës me rastin e vendosjes lidhur me kërkesën e paditësit/propozuesit. Sipas nenit 17 paragraf 1 të LPK-së është përcaktuar se *“Gjykata sipas detyrës zyrtare, menjëherë pas marrjes së padisë, duhet të konstatojë se a është kompetente për procedimin e çështjes që i është paraqitur”*. Ndërsa sipas nenit 19 të tij është përcaktuar se: *“Secila Gjykatë gjatë gjithë procedurës së shkallës së parë, sipas detyrës zyrtare kujdeset për kompetencën vet lëndore”*.

Nga aktvendimi i ankimuar në rastin konkret rezulton se gjykata e instancave më të ulëta kanë vendosur lidhur me kërkesën për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit, i cili ka derivuar nga detyrimet tatimore të tatimpaguesit ndaj ATK, kompetenca lëndore e këtij kontesti është përcaktuar me Ligjin nr.04/1-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/1-222, përkatësisht në nenin **81.B, paragraf 1**, ku është përcaktuar se: *“Divizioni Fiskal është përgjegjës për të gjykuar në shkallë të parë çdo vendim nga Departamenti i Ankesave në lidhje me taksat, detyrimet doganore dhe çdo kontribut tjetër të caktuar nga legjislacioni në fuqi”*.

Sipas nenit 81.C të këtij ligji, përcaktohet se: *“Për çështjet që nuk rregullohen me këtë ligj në lidhje me përgjegjësitë dhe rregullat procedurale të gjykatave kompetente, Ligji mbi konfliktet administrative, plotësim dhe ndryshim i Ligjit 03/L-202 dhe çdo ligj tjetër në fuqi në Kosovë duhet të zbatohet. Në rast të kundërshtimeve të këtij ligji me ligjet tjera dispozitat që gjenden në këtë ligj duhet të mbizotërojnë”*. Ndërsa sipas nenit 81.D përcaktohet se: *“Parashtruesi i ankesës përballë Divizionit Fiskal të Departamentit për Çështje Administrative në Gjykatën Themelore të Prishtinës duhet të jetë tatimpaguesi i cili ka pranuar vendimin e kundërshtuar nga administrata kompetente fiskale, doganore ose administrata komunale”*.

Nga theksimet si më lartë dhe dispozitat e cituara kolegji i Gjykatës Supreme konkludon se me rastin e funksionalizimit të Gjykatës Komerciale, divizioni fiskal i Gjykatës Themelore në Prishtinë është shuar dhe kompetencat e tij kanë kaluar në Gjykatë Komerciale, me ç'rast në dhomat e shkallës së parë është themeluar departamenti i veçantë fiskal për vendosje në çështjet juridiko-administrative tatimore, kundër vendimeve përfundimtare të organeve publike, për vendosjen e tatimeve ose detyrimeve tjera shtetërore, e po ashtu edhe dhomat e shkallës së dytë e cila vendos në kolegji, kundër vendimeve të shkallës së parë sipas ankesës së palëve në procedurë për vlerësimin e ligjshërisë së vendimeve përfundimtare.

Kolegji i kësaj gjykate, gjatë vlerësimit të aktvendimit të ankimuar ka gjetur se nuk mund të pranohet si i rregullt qëndrimi dhe përfundimi i gjykatës së shkallës së parë, përkitazi me mënyrën e vendosjes si në aktvendimin e ankimuar, kjo për faktin se gjykata e shkallës së parë nuk i ka evituar pengesat e natyrës procedurale, që ndërliken më çështjen e lejueshmërisë së procesit gjyqësor pranë gjykatës së shkallës së parë e që ndërliket me kompetencën e saj lëndore, për të vendosur përkitazi me çështjen e ngritur nga paditësi. Ndërsa gjykata e shkallës së dytë nuk ka shqyrtuar me vëmendje shkeljet procedurale për të cilat ka detyrim të kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Nga theksimet si më lartë me që aktvendimet e kontestuar janë të përfshirë me shkeljet e pretenduara si në kërkesë dhe si në kuptim të dispozitave të cekura si më lartë të LKA, dhe Ligjin nr.04/1-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/1-222, përkatësisht në nenin 81.B, paragraf 1, të njëjtit anulohen dhe lënda i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje, e cila udhëzohet ti mënjanojë të metat e përmendura më lartë, fillimisht të vlerësoj sipas detyrës zyrtare kompetencën e saj lëndore. Gjykatat e instancave më të ulëta në ri procedurë duhet ti kushtojnë kujdes të veçantë të gjeturave dhe vërejtjeve të theksuara si më lartë në këtë aktvendim.

Nga sa u parashtrua si më lartë dhe në bazë të nenit 54, paragrafi 2 dhe 3, të Ligjit për Konfliktet Administrative, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA SUPREME - PRISHTINË
ARJ nr.256/2024, me datë 21 Janar 2025

B. Profesionale,
Zanë Buçinca

Kryetari i kolegjit,
Ragip Namani